

## Mësim praktik (Metoda katër - shkallëshe) II

Shkalla	Hapat dhe përmbajtja e mësimit	Vërejtjet	Koha
2. Demonstrimi dhe sqarimi	Mësimdhënësi demonstroi tërë detyrën me një shpejtësi normale dhe lutë nxënësit që vetëm të shikojnë.	Parimi i vrojtimit Afërsia me realitetin	3'
	Ngjarja hap pas hapi: <b>1. Hapi i parë</b> - Largimi i mbulesës së rrotës dhe ruajtja e kujdes shme e saj, - Lirimi i filetave shtrënguese, - Sigurimi i automjetit kundër lëvizjes së lirë, - Ngritja lartë e automjetit.	Parimi i ecurisë hap pas hapi	2'
	Mësimdhënësi zhvillon ngadalë ngjarjen dhe në hapa duke sqaruar njëkohësisht se çka është duke bërë, si e bënë këtë dhe pse e bënë në këtë mënyrë. Nxënësi vrojton dhe dëgjon. Pas çdo hapi ai bënë përmbledhjen gojore të ngjarjes dhe nëse ka nevojë parashtron edhe pyetje.	Zbërthimi i punës	2'
	<b>2. Hapi i dytë</b> - Heqja e filetave shtrënguese dhe ruajtja e kujdes shme e tyre - Heqja e gomës, kontrollimi i gjendjes - Kontrollimi i gomës së re, vëzhgimi i shënimeve, - Vendosja e gomës, shtrëngimi i lehtë i filetave	Çështjet e sigurisë, Gomat e paprekura? Parimi i kujdesit	2'
<b>3. Hapi i tretë</b> - Lëshimi poshtë i automjetit - Shtrëngimi i fortë i filetave, - Vendosja e mbulesave të gomës.		2'	
3. Të lejohet imitimi	Nxënësi imiton hapat e punës dhe sqaron nga këndvështrimi i tij se çka është duke bërë, si është duke e bërë dhe pse e bënë në këtë mënyrë.  Ka parasysh sigurinë dhe kujdesin.  Ai mund të parashtrorë pyetje.  Mësimdhënësi vrojton dhe korigjon, duke mos dhënë kritika.	Mësimdhënësi kujdeset për një përdorim të kujdesshëm të pronës së klientit: Vendosja në të butë e mbulojës së gomës, kapakët e filetave në mbulesën e rrotës.  Parimi i të nxiturit	10'
4. Të lejohet ushtrimi	Nxënësi së pari bënë përmbledhjen gojore të tërë ngjarjes duke sqaruar njëkohësisht mënyrën e punës.  Pastaj mësimdhënësi lejon nxënësit të zhvillojnë disa ushtrime, vrojton dhe jep lavdata në rast të përparimeve në ushtrime.  Nëse vjen deri te lodhja e duarve, të mos lejohen ushtrime të mëtejme, përndryshe humbje e motivimit.	Parimi i reflektimit  Parimi i sigurimit të suksesit  Miratimi si motivim	10'